



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.102/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtarin ligjor Albert Haliti në kontestin tregtar administrativ të paditësit “A...M...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokati Jeton Omani nga Prishtina, rr. “UÇK” nr.24/1, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti 5,241.60 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, avokat Jeton Osmani, dhe të përfaqësuesit së autorizuar të palës së paditur, B.S., me datë 14.02.2023 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “A...M...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokati Jeton Omani nga Prishtina, rr. “UÇK” nr.24/1, si e pa bazuar.

II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.01.3.2.2/3297; 4433 i datës 21.04.2020, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi “A...M...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 22.05.2020, ka iniciuar kontestin tregtar-

administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë për anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/3297;4433 të datës 21.04.2020, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se: Mbesim në tërësi pranë të gjitha deklarimeve dhe gjykatën e njoftojmë se kemi pranuar plotësimin e ekspertizës financiare dhe ndaj të njëjtës nuk kemi vërejtje. Njëherit, gjykatës konform obligimit nga seanca e kaluar i dorëzojmë pagesat bankare të dt:05.03.2020 dhe 20.07.2020 me vulë të bankës. Andaj, i propozojmë gjykatës që të vazhdojmë me administrimin e provave. Në shkresat e lëndës janë edhe disa dokumente të cilat nuk janë të përkthyer në gjuhë zyrtare për gjykatë, nuk kërkojmë të i përkthejmë e as të i administrohen si provë pasi që nuk paraqesin elemente për të vërtetuar vlerën e transaksionit. Njëherit pas dëgjimit edhe të ekspertit financiar e bëj precizimin e kërkesëpadisë ashtu që kërkoj: që të aprovohet padia e paditësit si e bazuar, të anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/3297; 4433 i dt:21.04.2020 si dhe detyrohet e paditura që subjektit ankimor-paditësit, t'ia pranojë vlerën e mallit të prezantuar si në DUD-in R-7735/27.03.2020, R-4707/24.02.2020 dhe R-4911/25.02.2020, si dhe t'i kthehet shuma e paguar më tepër në vlerë prej 5,241.60 Euro, e të gjitha këto me kamatë ligjore 8% nga data e paraqitjes së padisë 22.05.2020 e deri në kthimin e plotë. Nga provat e administruara vërtetohet pa mëdyshje se paditësi ka vepruar në tërësi në harmoni me dispozitat ligjore gjatë importimit të mallrave të cekura si në DUD-at kontestues. Gjithashtu, nga provat e administruara vërtetohet se e paditura pa të drejtë e ka ngarkuar me taksa doganore importuese shtesë, andaj edhe gjykatës i propozoj që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 11.06.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka arsyetuar as

edhe me një provë të vetme. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor i autorizuari i palës së paditur deklaroi se: Mbesim pranë të cekurave nga seancat e kaluara. Plotësimin e ekspertizës financiare e kemi pranuar. Konsiderojmë se nuk ka harmonizimi në mes faturave dhe transaksionit bankar meqenëse shuma e përshkruar në transaksion dhe fatura nuk përputhet. Njëherit, konsiderojmë se dogana ka vepruar drejtë kur ka marrë vendimin kontestues bazuar në normat e KDA-së, andaj mbi bazën e këtyre fakteve dhe provave të administruara konsiderojmë se kërkesëpadia është e pabazuar andaj i propozoj gjykatës të njëjtën ta refuzoj dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues. Lidhur me plotësim ekspertizën financiare dhe dokumentet e bashkangjitura kësaj ekspertize të quajtura kredit-nota konsiderojmë se këto dokumente janë jo valide meqenëse të njëjtat nuk përmbajnë vulën e lëshuesit të tyre apo shitësit të mallit, nuk janë të nënshkruara dhe nuk dihet kur dhe si janë dërguar importuesi, këtu paditësit. Andaj, mbi këtë bazë i propozoj gjykatës që të njëjtave të mos ua fal besimin. Po ashtu, sa i përket pretendimit të paditësit se ka arritur të dëshmojë vlerën e transaksionit konsiderojmë se një pretendim i tillë është i pa qëndrueshëm meqenëse dokumentet e bashkangjitura dhe atë transaksionet bankare ndërkombëtare nuk arrijnë të dëshmojnë një gjë të tilli. Rrjedhimisht, subjekti nuk ka arritur të dëshmojë vlerën e transaksionit, andaj dogana me të drejtë ka bërë rivlerësimin e mallit kontestues. Mbi bazën e provave të administruara në këtë konflikt administrativ, shihet qartë se paditësi nuk ka arritur të dëshmojë as para doganës me rastin e zhdoganimit të mallit dhe fazat e tjera të procedurës administrative, e as para gjykatës që vlera e mallit të deklaruar është vlerë reale e paguar për mallin kontestues, andaj aktvendimi i nxjerrë nga Dogana e Kosovës është i ligjshëm. Andaj, mbi këtë bazë i propozojmë gjykatës që të sjell aktgjykimin përmes të cilit refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe të lë në fuqi aktvendimin kontestues të nxjerr nga Dogana e Kosovës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 14.02.2023, ka administruar provat dhe atë: DUD-at: R-7735/27.03.2020, R-4707/24.02.2020, R-4911/25.02.2020, R-18281/22.07.2019, Aktvendimi nr.01.3.2.2/3297; 4433 i dt:21.04.2020, Ankesa e ushtruar në Doganën e Kosovës e dt:02.03.2020, Kartela financiare për periudhën

01.01.2019 deri 28.02.2020, 01.01.2019 deri 23.04.2020, si dhe tabela me qarkullim për këtë periudhë, Transaksionet bankare ndërkombëtare SWIFT të dt:25.06.2019, 19.02.2020, 20.02.2020, 16.01.2020, 30.08.2019, 12.09.2019, 22.10.2019, 13.08.2019, 27.09.2019, 04.11.2019, 04.07.2019, 10.10.2019, 18.02.2020, 05.03.2020, 21.08.2019, 11.04.2019, 30.04.2019, 22.05.2019, 28.05.2019, 29.05.2019, 10.06.2019, 23.07.2019, 09.09.2019, 03.10.2019, 14.10.2019, 21.10.2019, 14.11.2019, 19.11.2019, 25.11.2019, 03.12.2019, 10.12.2019, 08.01.2020, 20.07.2020, Transaksionet bankare ndërkombëtare të dt:11.07.2019, Faturat nr:1024491, nr.ZY-20027403, nr.ZY-20027404, nr.1024492, nr.1024586, nr.ZY-724370, nr.ZY-724369, Pro fatura nr.ZY-261, Përgjigja në padi e dt:11.06.2021, Proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Proceset mbi marrjen e mostrave, Kërkesat për vlerësim të mallit të dt:08.04.2020 dhe 10.03.2020, Deklarata EXA, Mendimi për përcaktimin e vlerës i dt:03.06.2019, Ekspertiza financiare e dt:29.06.2020, plotësim ekspertiza financiare e dt:27.10.2020 dhe plotësim ekspertiza financiare e dt:07.12.2022, si dhe Kredit-notat 202950, 202951 dhe 202952.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestues fakti se subjekti “A...M...” sh.p.k me seli në Prishtinë, këtu paditësi përmes DUD-ave R-7735/27.03.2020, R-4707/24.02.2020 dhe R-4911/25.02.2020, të proceduar në ZBD I..., ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu, nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes procesit mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit nga neni 35 të

Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës Nr.03/L-109, sipas dosjes së vlerave. Nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës e për të cilën ankesë e paditura ka sjell aktvendimin nr.01.3.2.2/3297;4433, të datës 21.04.2020, me të cilin e ka refuzuar ankesën e këtui paditësit e ndaj të cilin aktvendim paditësi me padinë e datës 22.05.2020, ka iniciuar këtë kontest tregtar - administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve R-7735/27.03.2020, R-4707/24.02.2020 dhe R-4911/25.02.2020, të ZBD I..., si të pabazuar. Tutje e paditura në vendimin kontestues ka konstatuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmimi real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendim tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, gjithmonë duke pasur parasysh se deri tek një vlerësim i tillë është ardhur pasi që Dogana e Kosovës për mallrat lëndor ka referencat doganore pas analizimit të tregut vendor nga ana e Sektorit të Vlerës së mallit dhe pastaj të njëjtat janë vendosur në dosjen e vlerave të mallit. Po ashtu, e paditura në vendimin kontestues ka konstatuar se Zyra e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, zhdoganimeve të mëhershme dhe dosjes së vlerës, pasi që këto të dhëna janë marrë nga Sektori i Vlerës (Sektor i profesionalizuar për vlerësimin e mallrave), vlerësim ky i cili është bërë duke shfrytëzuar informatat e marra nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë. Bazuar në të gjitha këto burime të informatave janë përpiluar edhe çmimet për mallin lëndor të cilat konsiderohen si mjaftë të besueshme dhe pasqyrojnë vlerën reale të mallit lëndor kontestues. Po ashtu, në vendimin kontestues Dogana e Kosovës ka sqaruar se nuk është kontestuese se subjekti në procedurë ka paraqitur dokumentacion në përpjekje për të provuar se vlera e deklaruar është vlerë e paguar për mallin lëndor, mirëpo në procedurën e administrimit të provave, dokumentacioni përcjellës i mallit

lëndor për DUD-at e lartcekur është vlerësuar si provë e pamjaftueshme për arsye se mungon Kontrata e Shitblerjes që do të përcakton çmimin e mallit, llojin e mallit, kushtet e dërgesës. Pra, në këtë kuptim Dogana e Kosovës lidhur me mallin lëndor ka bërë analiza të çmimeve duke konkluduar se çmimet e prezantuara nga subjekti nuk mund të pranohen si reale, andaj, ka caktuar vlerë të re doganore bazuar në të dhënat e disponueshme, respektivisht të dhënave nga zhdoganimet e mëhershme nga dosja e vlerës.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44, paragrafi 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas paragrafi 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit A.nr.869/20 të datës 07.06.2022 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë konflikt administrativ me ekspertin financiar F.K., i cili ka pasur për detyrë të bëjë analizimin e dokumentacionit dhe shkresave të lëndës, dhe mbi këtë bazë të nxjerrë konstatimin sa ka qenë shuma e mjeteve monetare të paguara nga paditësi tek e paditura në emër të detyrimeve importuese doganore, si rezultat i rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes DUD-ave R-7735/27.03.2020, R-4707/24.02.2020 dhe R-4911/25.02.2020, të ZBD I.... Eksperti financiar në ekspertizën financiare të datës 29.06.2020, plotësimet e ekspertizës të datës 27.10.2020 dhe 07.12.2022, dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14.02.2023 ka deklaruar se: Eksperti ka kryer plotësimin e ekspertizës dhe në mënyrë të qartë ka kryer identifikimin e transaksionit bankar me faturat e lëshuara dhe harmonizimin e vlerave dhe mbetet prapa qëndrimit të dhënë në plotësim të ekspertizës. Përndryshe, eksperti po ashtu ka bashkangjitur dokumentet të cilat ose kanë munguar në ekspertizën e kaluar, siç është fjala për faturën nr.1024586 në vlerë prej 2,324.65 Euro.

Gjykata nga ekspertiza e lartcekur dhe plotësimet e saj ka gjetur se të njëjtat kanë dështuar të bëjnë lidhjen e transaksioneve bankare ndërkombëtare me faturat dhe profaturat e DUD-ve Kontestues dhe atë si në kuptim të referencës së përshkrimit të pagesave të realizuara ashtu edhe në kuptim të vlerës së tyre. Eksperti financiar edhe në seancën e datës 14.02.2023, pas pyetjeve të gjykatën nuk ka arritur ta bëjë harmonizimin e pagesave në kuptim të referencës së pagesave të kryera dhe vlerës së tyre me pro-fatura dhe fatura konkrete, ndërsa lidhur me Kredit-notat nr.202950, 202951 dhe 202952, se a janë të nënshkruara dhe vulosura nga eksportuesi si lëshues i këtyre dokumenteve dhe të njëjtat a janë të pranuar nga importuesi, këtu paditësi, i njëjti është përgjigjur se *“Kredit-notat nuk kanë as vule e as nënshkrim, mirëpo të njëjtat i janë dorëzuar ekspertit nga ana e palës paditëse. Po ashtu, edhe sa i përket pranimit të tyre nga këtu paditësi nuk është bashkangjitur ndonjë dëshmi e pranimit të tyre qoftë përmes postes apo emailit“*, dhe me këtë edhe vërteton se kredit notave në fjalë nuk duhet falur besimi i merituar.

Gjykata vlerëson si të pa-bazuar pretendimin e paditësit se aktvendimi i kontestuar është sjellë duke pasur fillimisht shkelje esenciale të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që nëse shikohet me kujdes arsyetimi i cili është dhënë nga ky Sektor fare qartë mund të shihet se i mungojnë faktet vendimtare mbi të cilat bazohet dispozitivi i tij, pasi që në arsyetim si prova potencohen të dhënat e disponueshme, por askund nuk ceket se cilat janë konkretisht ato të dhëna, e i cili pretendim është në kundërshtim me pretendimin e të paditurës se në rastin konkret nuk mund të veprohet sipas kërkesës së subjektit ankimor që malli të vlerësohet sipas dokumentacionit të prezantuar, pasi që subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të besueshëm dhe të kompletuar për të dëshmuar se çmimi i deklaruar është çmim real i paguar për mallin lëndor kontestues, dhe në rastin konkret vlera e deklaruar nuk do të pranohet si vlerë reale e paguar për mallin lëndor kontestues, gjithmonë duke pasur parasysh se nuk është e mjaftueshme që në kundërshtim të paraqiten pretendime të caktuara por është obligim i subjektit ankimor që komfor Ligjit të Procedurës Administrative pretendimet e tij të dëshmojë me prova të besueshme të cilat provojnë qartë me dokumentacion të kompletuar dhe origjinal të harmonizuar për vlerën reale të mallit të paguar ose të

pagueshëm për mallin lëndor, e të cilin konstatim faktik dhe qëndrim juridik të bërë nga Dogana e Kosovës, gjykata e pranon si të drejtë.

Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar Gjykatës provat materiale si pro faturën, faturat e mallit, dhe transaksionet bankare ndërkombëtare, e njëjta nuk ka arrit të dëshmoj vlerën reale të paguar për mallin lëndor, ngase sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret nuk ka harmonizim në mes të tyre, ngase shuma e përshkruar në transaksion dhe shuma në fatura nuk përputhet, sepse nga transaksionet bankare ndërkombëtare SWIFT shihet qartë se vlera e deklaruar është vlerë më e vogël se sa vlera e përcaktuar në faturat përkatëse. Nga DUD-i R-7735/27.03.2020 dhe faturat ZY-20027403 dhe ZY-20027404, si dhe transaksioni bankar i datës 05.03.2020, shihet se ka mospërputhje sa i përket vlerës, për faktin se shuma e dy faturave është në vlerë prej 14,998.74 €, ndërsa Transaksioni Bankar Ndërkombëtar i cili është bërë për pro faturën ZY-261 është në shumën prej 14,587.44 €, pra që i bie 411.03 € më pak. Ndërsa sa i përket DUD-ave R-4707 dhe R-4911, me faturat përkatëse nr.4491 dhe nr.4492 të cilat janë paguar përmes transaksionit bankar të datës 20.07.2020, shihet qartë se shuma e përgjithshme e këtyre dy faturave është 57,302.94 €, ndërsa transferi bankar i datës 20.07.2020 i cili në përshkrim përmban këto dy fatura dhe një faturë tjetër që nuk gjendet në shkresat e lëndës është në vlerë 55,949.32 €. Prandaj, nga kjo gjendje faktike gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret duhet vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në vijim Gjykata, pretendimin e paditësit se e paditura ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7, Parag 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ”* Nga këto dispozita Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38, par 2, të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtrij faktet në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato

fakte, të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi i cili thekson se kemi paraqitur dokumentacionin e nevojshëm se vlera e mallit është vlera reale e paguar, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë kontest tregtar administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtetë paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”*. Nga këto dispozita ligjore, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuara nga paditësi, duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë siç

parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacionin jo të harmonizuar, e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtet të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, parag. 1, dhe nenit 46, parag. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.102/22, datë 14.02.2023

Zyrtari Ligjor
Albert HALITI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.